

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Së pari më lejoni të ju falënderoj për praninë tuaj në këtë konferencë të fundvitit dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe efektiv që kemi kultivuar ndër vite me qëllim të informimit të drejtë të publikut rreth aktivitetit të BQK-së, si dhe zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend.

Komunikimi me mediat është pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e aktivitetit të BQK-së. Përmes raportimit të drejtë nga ana juaj, ne kemi arritur që ta mbajmë publikun mirë të informuar rreth zhvillimeve në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit, duke ndikuar që sjellja e publikut në raport me kushtet e krijuara në ekonomi të jetë racionale. Prandaj, dëshiroj që të shfrytëzoj këtë rast për të ju shprehur vlerësimin tim të lartë për sakrificën dhe profesionalizmin e treguar edhe gjatë këtij viti.

Me gjithë vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar, unë jam i lumtur që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur edhe në këtë vit të zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, i cili jo vetëm se arriti të përballojë zhvillimet e pafavorshme ekonomike në vend, por edhe të jetë një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët, dhe me këtë edhe të ekonomisë së vendit.

Tani, më lejoni që para jush të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan ekonominë dhe sistemin financiar të vendit gjatë këtij viti, duke u bazuar në të dhënat e fundit që i kemi në dispozicion për sektorët përkatës.

Ekonomia e Kosovës e filloi vitin 2021 me një perspektivë mjaft të pasigurt, duke qenë se po linim pas një vit mjaft të vështirë, në të cilin masat kufizuese ndaj përhapjes së pandemisë kishin shkaktuar një rënie ekonomike reale prej 5.3 përqind, e cila paraqiti goditjen më të madhe për ekonominë në 20 vitet e fundit.

Megjithatë, lehtësimi i masave të lëvizjes së qytetarëve brenda dhe jashtë vendit, të cilat rezultuan me një fluks të madh të ardhjes së diasporës për vizitë në Kosovë gjatë muajve të verës, së bashku me politikën mbështetëse të Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për ekonominë, bënë që viti 2021 të karakterizohet me zhvillime mjaft pozitive për ekonominë e vendit, e cila sipas vlerësimeve të fundit të BQK-së pritet të shënojë një **normë reale të rritjes** prej rreth **9.9 përqind**.

Bazuar në të dhënat e regjistruara deri me tetor të këtij viti, **shpenzimet e jorezidentëve** në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave janë nga diaspora, ishin në shumë prej **1.33 miliardë euro**, e cila paraqet një **rritje prej 151.3 përqind** në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Po ashtu, viti 2021 shënoi një ritëm më të shpejtë të rritjes edhe për remitencat e dërguara nga diaspora në Kosovë. Vlera e **remitencave** të pranuar deri në fund të muajit tetor 2021 është **956 milionë euro**, që paraqet rritje vjetore prej **20.0 përqind**.

Rritja e kërkesës së brendshme në Kosovë gjatë këtij viti u reflektua në një vlerë më të lartë të **importit të mallrave**, i cili deri në nëntor 2021 shënoi vlerën **4.2 miliardë euro** apo një rritje vjetore prej **42.5 përqind**. Në anën tjetër, **eksporti i mallrave** shënoi vlerën prej **684.7 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej **60 përqind**. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, **deficiti tregtar** në llogarinë e mallrave deri në muajin nëntor 2021 regjistroi vlerën prej **3.5 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore prej **39.6 përqind**.

Në anën tjetër, eksporti i shërbimeve deri në shtator 2021 shënoi vlerën prej **1.59 miliardë euro**, duke shënuar një rritje vjetore prej **117 përqind**, që ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes së vizitave të bashkatdhetarëve tanë dhe turistëve në vend. Me rritje u karakterizua edhe importi i shërbimeve që deri më shtator 2021 regjistroi vlerën prej **642 milionë euro**.

Pra gjithsej importet e mallrave dhe shërbimeve deri në muajin nëntor të këtij viti janë në shumë rreth **5 miliardë euro**, ndërsa eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë në shumë rreth **2.3 miliardë euro**.

Për sa i përket investimeve të huaja direkte, vlera e tyre deri në shtator 2021 arriti në **389 milionë euro**, në krahasim me vlerën prej **254 milionë euro** të regjistruar deri në shtator 2020. Gjatë kësaj periudhe, rritje të lartë shënuan IHD-të tek investimet në patundshmëri, të cilat shënuan vlerën prej **265 milionë euro**, në krahasim me vlerën prej **129 milionë euro** të regjistruar deri në fund të shtatorit 2020, apo shprehur në përqindje, kemi një rritje prej 106 përqind. Në anën tjetër, investimet në sektorin e shërbimeve financiare, qëndruan në rreth **87 milionë euro**, në krahasim me vlerën prej rreth **67 milionë euro** të regjistruar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Për sa i përket treguesve tjerë makroekonomikë, vlen të theksohet **se mesatarja e inflacionit deri në nëntor 2021** shënoi normën prej **3.1 përqind** në krahasim me mesataren vjetore prej **0.2 përqind** për vitin 2020. Ndërsa, norma e inflacionit vetëm për muajin nëntor 2021 ishte **6.9 përqind**, gjë që tregon se po ballafaqohemi me një trend në rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Rritja e normës së inflacionit në Kosovë kryesisht reflekton rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të cilat në Kosovë transmetohen përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara.

Sa i përket sistemit financiar, është shumë e rëndësishme të theksohet se Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem financiar të shëndoshë, i cili jo vetëm se u dëshmuar i aftë ta përballojë një ambient shumë të pafavorshëm ekonomik gjatë vitit 2020, por edhe të merr një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë për ta përballuar krizën me pasoja sa më të vogla që ishte e mundur.

Gjatë vitit të kaluar, duke parë se ekonomia e vendit po hynte në krizë, dhe se bizneset dhe qytetarët filluan të ballafaqohen me vështirësi financiare, BQK-ja duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në bashkëveprim me institucionet kredithënëse në Kosovë, ndërmori një varg masash për të ndihmuar ekonominë që të përballojë në mënyrë sa më të lehtë sfidat e kësaj krize.

Fillimisht kemi ndërmarrë masën për aplikimin e moratoriumit për pagesat e kredive **pa asnjë masë ndëshkuese** për të gjithë huamarrësit që janë ndikuar negativisht nga pandemia. Ky moratorium përkohësisht i ka liruar kredimarrësit nga ngarkesa e pagesës së kredisë, duke e përmirësuar kështu pozitën e tyre të likuiditetit për financimin e nevojave të tjera.

Pas përfundimit të periudhës së moratoriumit, BQK-ja ka publikuar udhëzuesin për ristrukturimin e kredive me qëllim të vendosjes së kriterëve në të cilat duhet të bazohej procesi i ristrukturimit të kredive për huamarrësit që kanë hasur në vështirësi financiare si pasojë e pandemisë. Udhëzuesi për ristrukturimin e kredive ka bërë të mundur që t'u lehtësohet barra kreditorë kredimarrësve pa implikuar ndonjë përkeqësim të klasifikimit të tyre në regjistrin kreditor të Kosovës. Udhëzuesit për ristrukturim të kredive iu është zgjatur afati i aplikimit deri në fund të muajit mars të vitit 2021, me qëllim të zbatimit sa më të gjerë për bizneset në vështirësi financiare.

Masat e ndërmarra nga BQK-ja u vlerësuan si shumë adekuate, si nga publiku vendor, ashtu edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare siç janë **Fondi**

Monetar Ndërkombëtar në raportin e Artikullit IV për Kosovën dhe Banka Botërore.

Sektori bankar, përkundër rreziqeve të rritura si pasojë e vështirësive ekonomike që kanë trashëguar bizneset nga periudha e pandemisë, ka vazhduar të rrisë kreditimin dhe të ruaj shkallën e qëndrueshmërisë. Deri në muajin nëntor 2021, vlera e **kredive të reja** të lëshuara nga sektori bankar ishte rreth **1.6 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore prej 21 përqind, përderisa vlera e përgjithshme e kredive aktive në sektorin bankar deri në nëntor 2021 ishte **3.7 miliardë euro**, e cila paraqet një rritje vjetore prej **14.7 përqind**.

Gjithsej mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë këtij viti, duke arritur vlerën prej **5.79 miliardë euro** në nëntor 2021, e cila paraqet një rritje vjetore prej **13 përqind**.

Sektori bankar vazhdon të gëzojë besim të lartë tek publiku, besim ky i shprehur edhe me rritjen e vazhdueshme të depozitave. Në nëntor 2021, vlera e përgjithshme e depozitave ishte rreth **4.67 miliardë euro**, që paraqet një rritje vjetore prej **12.8 përqind**. Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga **depozitat e ekonomive familjare**, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar me pjesëmarrje prej **69.6 përqind** në totalin e depozitave, e të cilat deri në tetor 2021 shënuan rritje vjetore prej **18 përqind**.

Norma mesatare e interesit në kredi në nëntor 2021 shënoi **5.6 përqind**, e cila është më e ulët në krahasim me normën prej **6.1 përqind** të regjistruar në nëntor 2020. Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të **kredive joperformuese prej vetëm 2.3 përqind** në nëntor 2021. **Mbulueshmëria e kredive joperformuese** me provizione për humbje nga kreditë mbetet në nivel të

lartë prej **147.8 përqind**, që dëshmon për nivele adekuate të provizioneve në sektorin bankar.

Sektori bankar vazhdon të ketë tregues të lartë të **mjaftueshmërisë së kapitalit** prej **17.5 përqind** në fund të tetorit, që vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal rregullativ prej 12.0 përqind.

Pozita e **likuiditetit** të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në korrik ishte **38.4 përqind**, që është lartë mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

Zhvillime pozitive kemi edhe te sektori i sigurimeve. **Asetet e sektorit të sigurimeve**, që përfaqësojnë rreth 3.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në shtator 2021 shënuan vlerën prej **235.7 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej **10.0 përqind**.

Është e rëndësishme të theksohet që ekuiteti i sektorit të sigurimeve edhe këtë vit ka shënuar rritje, si rezultat i kërkesave të BQK-së për shtim të kapitalit. Vlera e ekuitetit të sigurveve në shtator 2021 ishte **61.1 milionë euro** me një rritje vjetore prej **5.9 përqind**.

Ndërkohë që ky sektor ka vazhduar të ketë **performancë pozitive financiare** edhe gjatë kësaj periudhe, duke regjistruar fitim neto në vlerë prej **5.9 milionë euro** deri në shtator 2021. Primet bruto të shkruara nga kompanitë e sigurimit deri në shtator 2021 shënuan vlerën prej **86.9 milionë euro** apo një rritje vjetore prej **20.2 përqind**, përderisa dëmet e paguara bruto shënuan vlerën prej **45.6 milionë euro** apo një rritje vjetore prej **30.0 përqind**.

Si rezultat i gjendjes së rënduar financiare dhe mos përmbushjes së kërkesave ligjore për kapital, me qëllim të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe me qëllim të parandalimit të rritjes së ndikimit negativ në tregun e sigurimeve dhe në sistemin

financiar në përgjithësi, gjatë këtij viti BQK-ja duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për BQK-në dhe Ligji për Sigurimet, ka marrë vendim për revokimin e licencës së siguruesit "Kosova e Re".

Ky vendim ishte në vazhden e një sërë masave të ndërmarra nga ana e BQK-së për rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve, me qëllim të sigurimit të një sektori stabil dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të BQK-së.

Edhe sektori pensional gjatë këtij viti u karakterizua me rritje, krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional në tetor 2021 arriti në **2.29 miliardë euro** krahasuar me 2.07 miliardë sa ishin në tetor 2020, që përkon me një rritje vjetore prej **10.7 përqind**. Sektori pensional shënoi performancë pozitive financiare, duke shënuar kthim në investime në vlerë prej rreth 133 milionë euro. Kontributet e reja pensionale gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej rreth 157 milionë euro.

Sa i përket sektorit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, deri në nëntor 2021, **asetet e këtij sektori arritën vlerën prej 343.1 milionë euro** duke shënuar rritje vjetore prej **8.6 përqind**.

Gjithsej kreditë aktive të këtij sektori në nëntor 2021 shënuan vlerën prej 238 milionë euro, apo rritje vjetore prej **16.1 përqind**.

Norma mesatare e interesit në kreditë e reja të emetuara nga institucionet mikrofinanciare nëntor 2021 ishte **18.8 përqind**, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte **19.7 përqind**. Edhe në këtë sektor vlerësohet cilësia e mirë e portofolit kreditor me një normë të **kredivë joperformuese prej 2.9 përqind**.

Për sa i përket zhvillimeve të brendshme, BQK-ja edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar me avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj profesionale në të gjitha fushat e veprimit të saj.

Përkundër situatës së krijuar dhe kushteve jo shumë të favorshme në tregjet ndërkombëtare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të ruajë qëndrueshmërinë e saj financiare dhe performancën e mirë të institucionit, duke gjeneruar rezultat financiar pozitiv.

BQK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojë aktivitetin e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke krijuar kushtet për zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme financiare, në linjë me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë, duke përfshirë edhe zhvillimin e segmenteve të reja të sistemit financiar siç është tregu i kapitalit, i cili kërkon një bashkëveprim të gjerë ndërinstitucional.

Para se të pranoj pyetjet tuaja, më lejoni për fund të ju njoftoj se BQK-ja ka vazhduar me shpalljen e konkursit tanimë tradicional, për çmimin “Ekonomist i Ri”. Me këtë rast dëshiroj t’i falënderoj dhe përgëzojë të gjithë kandidatët për punimet e tyre që i kanë dorëzuar në kuadër të kësaj gare.

Ky aktivitet ka për qëllim nxitjen e aktivitetit hulumtues në fushën e ekonomisë në mesin e të rinjve.

Bazuar në vlerësimin e komisionit profesional për punimet e sjella, kam kënaqësinë që të shpallë fituesen e këtij çmimi, Erzana Uka me temën “**Impakti i digjitalizimit në sistemin bankar**”.

Në fund, duke shpresuar dhe besuar se viti i ardhshëm do të jetë një vit më pozitiv në të gjitha aspektet, ju uroj shumë shëndet, gëzime dhe suksese të gjithë juve dhe familjeve tuaja.